Vendim nr. 338, datë 21.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 21.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 61 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ALEKSANDRA SPAHO (HAMATI),** përfaqësuar nga avokat Nevzat Tarelli, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2019-4222 (613), datë 04.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 30-2023-3766 (1176), datë 10.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1937, datë 09.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, shkronja "d", 42, pika 2, 134, shkronja "i", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për veprat penale të vjedhjes, duke shpërdoruar detyrën, si dhe të falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara nga nenet 135 dhe 186, paragrafi i tretë, të Kodit Penal (*KP*). Sipas prokurorisë, gjatë periudhës janar 2014 - korrik 2017, kur ushtronte detyrën e përgjegjëses së Zyrës Postare Pirg, kërkuesja ka përvetësuar në mënyrë të vazhdueshme shuma lekësh, të destinuara për pagesa pensionesh, transportin e nxënësve, përfitues të Bashkisë Maliq dhe kontribute shoqërore. Gjithashtu, duke shfrytëzuar detyrën, ajo ka falsifikuar disa mandate pagesash.

2. Pas përfundimit të hetimeve, në datën 03.09.2018, prokurori ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, sipas akuzës. Kjo kërkesë është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake me vendimin nr. 606 sp, datë 03.12.2018.

3. Gjykimi është zhvilluar me procedurë të zakonshme dhe, në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2019-4222(613), datë 04.12.2019, e ka deklaruar kërkuesen fajtore, sipas akuzës, duke e dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të KP-së, gjykata ka pezulluar ekzekutimin e dënimit, duke e vënë kërkuesen në provë për 4 vjet. Mbi bazën e apelit të kërkueses, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 30-2023-3766(1176), datë 10.07.2023, ka lënë në fuqi vendimin për akuzën e vjedhjes, duke shpërdoruar detyrën, ndërsa ka vendosur pushimin e çështjes për akuzën e falsifikimit të dokumenteve. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1937, datë 09.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në datën 22.07.2026 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

5. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

5.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat e faktit nuk kanë gjykuar me objektivitet dhe nuk i kanë çmuar dyshimet në favor të saj.

5.2. *E drejta për t'u dëgjuar*, e garantuar nga neni 33, pika 1, i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit dhe ka refuzuar shqyrtimin gjyqësor, duke vendosur mospranimin e rekursit e duke i mohuar asaj të drejtën për të paraqitur argumentet dhe provat.

5.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjykatat e faktit nuk kanë vlerësuar objektivisht provat. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse ka vendosur mospranimin e rekursit duke mospërmbushur *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* duke shkelur nenin 142, pika 1, të Kushtetutës.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

6. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret paraprake të pranueshmërisë janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

8. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimimit *ratione materiae* të kërkueses, pra për të verifikuar nëse pretendimet e ngritura prej saj kanë natyrë kushtetuese. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për t'u dëgjuar dhe së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuara nga nenet 30, 33, 42 dhe 142 të Kushtetutës, të cilat, *prima facie* kanë natyrë kushtetuese dhe përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

9. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, kërkuesja ka parashtruar se gjykatat e faktit nuk kanë gjykuar me objektivitet dhe nuk i kanë çmuar dyshimet në favor të saj.

10. Neni 30 i Kushtetutës parashikon se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka pohuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm *(shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur përfundimin për fajësinë e kërkueses në provat e administruara gjatë gjykimit, duke vlerësuar se ajo, në ushtrim të detyrës së përgjegjëses së Zyrës Postare Pirg, kishte përvetësuar shuma të destinuara për përfitues të ndryshëm, duke përdorur mandate pagesash të falsifikuara. Në këtë drejtim, gjykata ka marrë në konsideratë detyrën funksionale të kërkueses, mungesën e nënshkrimeve të përfituesve në mandatet e pagesave, kthimin e shumave vetëm pas ankesave të pensionistëve, si dhe deklarimet e dëshmitarëve lidhur me administrimin e vulës dhe dokumentacionit postar.

12. Gjykata e apelit e ka vlerësuar të drejtë përfundimin për fajësinë e kërkueses për veprën penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, duke arsyetuar për secilin episod se elementet objektive dhe subjektive të saj ishin provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërkohë, ajo ka vendosur pushimin e akuzës për falsifikimin e dokumenteve, duke vlerësuar se këto veprime ishin kryer në funksion të përvetësimit të shumave dhe përbënin pjesë të veprimeve me të cilat ishte realizuar vjedhja. Nga ana e saj, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit kishte analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, në një proces të zhvilluar sipas parimit të kontradiktoritetit, ndërsa kërkuesja nuk kishte parashtruar shkaqe ligjore që justifikonin shqyrtimin e rekursit.

13. Për sa më sipër, Kolegji vëren se argumentet e kërkueses për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë janë të përgjithshme dhe të pamjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim. Nga ana tjetër, gjykatat e zakonshme kanë individualizuar përgjegjësinë penale të saj,

duke përcaktuar veprimet konkrete dhe duke mbështetur përfundimin për fajësinë në një sërë provash shkresore dhe verbale, përfshirë mandatet e pagesave, aktin e ekspertimit grafik dhe deklarimet e dëshmitarëve. Në këtë drejtim, Kolegji thekson se vlerësimi i provave dhe i fuqisë së tyre provuese është, si rregull, kompetencë e gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në mungesë të argumenteve konkrete që të evidentojnë cenimin e standardit kushtetues të prezumimit të pafajësisë, Kolegji çmon se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

14. Lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar*, kërkuesja ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit dhe, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka refuzuar shqyrtimin gjyqësor të çështjes, duke i mohuar mundësinë për të paraqitur argumentet dhe provat e saj.

15. Neni 33, pika 1, i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të dëgjohet përpara se të gjykohet. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, mbi bazën e dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk nënkupton se atyre u është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi, në kuptimin kushtetues, kjo e drejtë mund të realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura prej tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që të paktën në një shkallë gjykimi është zhvilluar seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës palës i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, sipas dispozitave procedurale të KPP-së, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në zbatim të këtyre dispozitave, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar paraprakisht rekursin e kërkueses dhe ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk plotësonte kriteret ligjore të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Për rrjedhojë, shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit është zhvilluar në përputhje me formën e gjykimit të përcaktuar nga ligji procedural, pa qenë e nevojshme prania fizike e kërkueses për verifikimin e kritereve të pranueshmërisë. Për më tepër, rezulton se gjykimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit është zhvilluar në seanca gjyqësore publike, në praninë e kërkueses dhe të mbrojtësit të zgjedhur prej saj, gjatë të cilave ajo ka pasur mundësinë të dëgjohet dhe të mbrohet. Në këto rrethana, Kolegji çmon se vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

17. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, kërkuesja ka parashtruar se gjykatat e faktit nuk kanë vlerësuar në mënyrë objektive provat e administruara, ndërsa Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm, nuk ka respektuar *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se arsyetimi i vendimit gjyqësor përbën element thelbësor të një vendimi të drejtë, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe u mundëson kundërshtimin e tij. Shtrirja e detyrimit për arsyetim ndryshon në varësi të rrethanave konkrete dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të pasqyrohen shkaqet e rekursit. Një arsyetim i tillë nuk cenon standardin kushtetues, për sa kohë që shpreh, në thelb, arsyet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në dritën e këtyre standardeve, Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë shqyrtuar rrethanat e çështjes, duke analizuar secilin prej episodeve të vjedhjes së fondeve që u përkisnin përfituesve nga grupe vulnerabël të shoqërisë, si, pensionistë, fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara. Vendimet e tyre përmbajnë analizën e provave të administruara, vlerësimin e tyre në raport me njëra-tjetrën dhe arsyet mbi të cilat është mbështetur përfundimi për deklarimin fajtore të kërkueses. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në ushtrim të kompetencave të saj për shqyrtimin e rekursit, ka arsyetuar se pretendimet që lidhen me vlerësimin e provave dalin jashtë juridiksionit të saj, se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkueses dhe se rekursi nuk ngrinte çështje të ligjit material ose procedural që të vinin në dyshim ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së apelit. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë pasqyron në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes, arsyetimin e gjykatave më të ulëta, shkaqet e rekursit dhe argumentet mbi të cilat është mbështetur mospranimi i tij, sipas nenit 432 të KPP-së. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbushin standardin kushtetues të arsyetimit dhe se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.